



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 951/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** programi i studimit të Kolegjit Universum, dega në Ferizaj, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. *Biznes dhe Menaxhment, BA*, 180 ECTS, maksimumi 200 studentë për vit akademik,
- II. **Akreditohen** programet e studimit të Kolegjit Universum, dega në Ferizaj, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. *Dizajn Mode, BA*, 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik,
 2. *Teknik Dentar, Bachelor Profesional*, 180 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik,
- III. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji Universum, dega në Ferizaj që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji Universum, dega në Ferizaj që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji Universum, dega në Ferizaj në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Biznes dhe Menaxhment, BA</i> , 180 ECTS Ri akreditim	Filipos Ruxho Ganimete Podvorica Fejzullah Beha
2.	<i>Dizajn Mode, BA</i> , 180 ECTS Akreditim	Nevila Muka Arjana Blakaj Drenusha Zeka Hana Bakalli
3.	<i>Teknik Dentar, Bachelor Profesional</i> , 180 ECTS Akreditim	Albana Agani Endrit Ibishi Blerina Kolgeci Astrit Sokoli

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Universum, dega në Ferizaj me këtë përbërje: Mikus Dubickis, Adrian Stan, Alan Brickwood dhe Marko Komšo. Vizita është organizuar më 06.04.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Biznes dhe Menaxhment, BA*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht dy (2) dhe nuk e përmbush një (1) standard.
- Për programin e studimit *Dizajn Mode, BA*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht shtatë (7) standarde.
- Për programin e studimit *Teknik Dentar, Bachelor Profesional*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht tri (3) dhe pjesërisht tri (3) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Universum, dega në Ferizaj dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicjimi i aktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Universum, dega në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së

Prof. Ass. Dr. Hasnija
Kryetare e Këshillit Shtetëror

